



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 17 paragrafi 1 pika 10, neni 22, neni 23 paragrafi 1 dhe neni 82 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019), neni 40 dhe Neni 41 i Rregullores së Punës të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm: KSHPK) në seancën e 87 -të të KSHPK -së të mbajtur më 01.06.2023 të morri

VENDIM

Procedura për verifikimin e bazës për fitimin e patundshmërisë nga -----, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Veles, e formuar pas denoncimit të parashtruesit të njohur NDËRPRITET.

Согласно со одредбите на Законот за спречување на корупцијата и судирот на интереси, ДКСК нема елементи за натамошно постапување по предметот број 08-1409/1 од 05.04.2021 година.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, KSHPK nuk ka elemente për veprim të mëtejshëm sipas lëndës me numër 08-1409/1 të datës 05.04.2021.

Предметот со број 08-1409/1 од 05.04.2021 година да се затвори и да се архивира.

Lënda me numër 08-1409/1 datës 05.04.2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 08-1409 / 1 të datës 05.04.2021 u formua sipas denoncimit të parashtruar nga ana e personit -----nga -----.

Me denoncim kërkohet nga KSHPK-ja që të hetojë mënyrën e fitimit të patundshmërisë, banesë në Shkup në rrugën -----, nga gjyqtari i Gjykatës Themelore në Veles, -----.

Në denioncim, parashtruesi shpreh dyshimin se gjyqtari i emëruar e ka fituar banesën në mënyrë korruptive gjatë kryerjes së funksionit gjyqësor.

KSHPK-ja nga evidenca e saj ka konstatuar se ----- ka raportuar blerjen e paluajtshmërisë së përmendur me formularin për raportim të ndryshimit të gjendjes pasurore të datës 04.01.2018 dorëzuar në KSHPK.

Krahas formularit, ai ka dorëzuar Aktvendimin e Gjykatës Themelore Shkup 2 Shkup me numër ----- të datës 07.05.2017, nga ku rezulton se prona është fituar në procedurë falimentimi me shitje elektronike të paluajtshmërisë.

Gjithashtu, KSHPK-ja ka kërkuar nga personi i emëruar, me shkresën nr. 08-1601/1 datë 14.03.2023, të dhëna për burimin e mjeteve për blerjen e pasurisë së paluajtshme të specifikuar, si dhe nga cila llogari bankare janë paguar të njëjtat.

----- me shkresë të dorëzuar më 31.03.2023, e njofton Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit se një pjesë e mjeteve për blerjen e banesës janë fituar nga paga dhe shtesat në pagë nga ushtrimi i detyrës së gjyqtarit dhe më parë edhe nga ushtrimin e profesionit të avokatisë dhe një pjesë e mjeteve sigurohen nga ndihma monetare nga personat me të cilët ai jeton në një bashkësi familjare, pra nga prindërit dhe bashkëshortja. Në të njëjtën kohë, personi i përmendur thekson se mjetet janë paguar nga llogaria e tij në -----

Pas shqyrtimit të aktgjykimit të dorëzuar nga gjyqtari i emëruar, KSHPK-ja ka konstatuar se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent në rastin konkret. Në bazë të sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të vendimit.

Përgatiti: A.Ç., udhëheqës i njësisë
Miratoi: G.T., anëtar i KSHPK - së

KOMISIONI SHTETËRO
PËR PARANDALIMIN EKORRUPSIONIT
Nënkryetar,
Katica Nikolovska

